

LUAN KOKONA

TEMA E JETËS SË RE NË KRIJIMTARINË POETIKE TË LL. SILIQIT

Llazar Siliqi bën pjesë ndër ata shkrimtarë, të cilët jo vetëm e përshëndetën ngadhnjimin e revolucionit popullor, por edhe morën pjesë aktive në luftën popullore për t'i hapur udhën fitores mbi skllavëruesit e huaj dhe tradhëtarët.

Gjatë viteve të Luftës nacionalçlirimtare Ll. Siliqi shkruan shumë vjersha, të cilat i këndonin luftës heroike që bënte populli për çlirimin e vet dhe ngjallnin tek njerëzit ndjenjën e patriotizmit dhe të qendresës përballë armiqve.

Pas çlirimit dhe sidomos në vitet e ndërtimit socialist poeti merret me një veprimtari të gjerë shoqërore-letrare, shkruan vjersha dhe artikuj: në fillim drejton seksionin e letërsisë në gazetën «Rinia» (sot «Zëri i rinisë»), kurse më vonë drejton me radhë organet «Letrari i ri», «Nëndori» dhe «Drita». Poeti jeton në zjarrin e ngjarjeve. Krahas veprimtarisë si aktivist shoqëror, ai shkruan shumë, duke e zgjeruar diapazonin e vjershave të tij. Në këtë mënyrë ai u bë ndër shkrimtarët më të njohur të letërsisë sonë të realizmit socialist.

Tematika e krijimeve poetike të tij u përcaktua nga detyrat më të ngutshme e më të mëdha politike dhe shoqërore të kohës. Çdo vepër e tij ishte si jehonë e shpejtë dhe e drejtpërdrejtë e ndodhive dhe fakteve më të rëndësishme të jetës së brendshme dhe të jashtme të vendit. Mbrotjtja e sakrificave dhe e gjakut, që populli shqiptar derdhi në vitet e Luftës nacionalçlirimtare, fshikullimi i armiqve të popujve të posaçliruar nga fashizmi, demaskimi i planeve të imperialistëve për të përgatitur një luftë të re, — këto ishin detyrat që i vuri vetes poeti në atë kohë. Por tema themelore e krijimtarisë së Ll. Siliqit, e cila hyri në të si pjesë organike, ishte tema e jetës së re.

Në vjershat e Ll. Siliqit figura e jetës së lumtur, që herët a vonë do të vinte, shfaqet qysh para çlirimit. Të ardhmen e masave punonjëse poeti e përfytyron të ndritshme dhe plot begati; ajo do të ngruhej me punën e përbashkët të njerëzve të lirë nga shfrytëzimi klasor.

Katunde t'bukra e t'frytshme
me shpija t'bardha e t'dritshme,
ku lulzon shndeti dhe lulzon hareja
e'j jete t'drejtë e t'rë edhe ku puna
nuk mbyt e as nuk asht mjet shfrytëzimi,
me fusha t'blera e ara t'zverdueme
nga fryti i pjekun, fryti i pun's s'bashkueme
(«Me duerët tueja») 1

1) Citimet e poezive, të shqyrtuara këtu dhe të botuara që prej çlirimit dhe gjer në vitin 1959, janë marrë nga vëll.: Ll. Siliqi, *Kangët nuk mbeten kurr të pakëndue-mel*, («Vjersha dhe poema»), T., 1959.

Kjo paraqitje e jetës së re, që do të ndërtohej në Shqipëri pas çlirimit, ishte e përgjithshme dhe e papërcaktuar; ajo nuk ishte një pasqyrim konkret i lindur nga një bazë reale. Ishte ajo ëndërra romantike e poetit të ri, i cili në ato vite (rreth 1942) nuk e kishte ende të qartë se si do të ishte jeta e lumtur për popullin.

Pas ngadhënjimit të revolucionit popullor tema e jetës së re nis e zë një vend përherë e më të madh në veprën poetike të Ll. Siliqit. Çdo temë që trajton, qoftë kjo lufta çlirimtare që sapo mbaroi, qoftë demaskimi i manevrave dhe intrigave të forcave agresive imperialiste, poeti synon ta lidhë me lindjen dhe afirmimin e botës së re. Poema «Pristina», fragmente të të cilës i botoi më 1946, është një hymn drejtuar luftës heroike që bëri populli shqiptar kundër pushtuesve fashistë. Por duke rrëfyer me patetikë emocionale për aktin e lartë historik të popullit tonë gjatë luftës së dytë botërore, poeti përvijon me disa fjalë edhe jetën e re që ka nisur pas çlirimit.

Sirena e punës këtu por fishkllon
e djersa,

si gjaku nga plagt' e dëshmorve,
rigon,

Në vargun «Shkëlqimi i diellit tonë / po i verbon», me të cilin nis poema, ai sikur do të theksojë se lufta për të mbrojtur epopenë e madhe popullore nga shpifjet e imperialistëve dhe të veglave të tyre ishte një luftë edhe për mbrojtjen e jetës së re, që populli shqiptar kishte nisur ta ndërtonte në truallin e vet.

Në fund të viteve '40 dhe në fillim të viteve '50 Ll. Siliqi shkruan një varg vjershash, ku me nota të ngritura emocionale shpreh ngazëllimin për ndryshimet e mëdha që po ndodhnin në jetën e vendit, për entuziazmin dhe hovin e njerëzve tanë.

Në poezinë shqipe të viteve të para pas çlirimit u zhvillua prirja për ta pasqyruar jetën në plan liriko-emocional. Shembja përtokë e botës së vjetër dhe shfaqja e elementeve dhe formave socialiste, ngjallin tek poetët ndjenjën e gëzimit dhe të krenarisë. Ata synojnë të japin atmosferën entuziazte që mbretëron në të katër anët e vendit, hapenë e ndërtuesve të jetës së re. Kjo frymë liriko-emocionale karakterizon pothuajse të gjitha krijimet poetike të kësaj kohe, në të cilat me nota romantike i këndohet ndërtimit të shoqërisë së re.

Toni i ngritur emocional patetik shquan edhe vjershat «Përhëndetje», «Dhuratë në ditën e lindjes», «Rruga e lumtunis», «1 Maji», «Sheqeri i parë», etj.² Puna e vrullshme për t'i ndryshuar pamjen atdheut, transformimet e shpejta e të mëdha që u arritën në të gjitha fushat, dhe sukseset e njerëzvet tanë jepen në këto poezi përmes perceptimit liriko-subjektiv të poetit. Ngazëllimi për fitoret e arritura dhe perspektivat e ndritura që i janë hapur vendit, përbën brendinë kryesore emocionale të këtyre poezive.

Ndjenja e një lëvizje të shpejtë e të pandalshme drejt lartësish të reja, lëvizje që nuk njuh pengesa, por çan me vrull përpara, mbush vjershën «Atdheut» (1953)³, në të cilën Shqipëria krahasohet me një përrua, që zbret plot gaz nëpër lugina, duke flakur tej çdo gjë që pengon hovin e tij.

2) Shih vëll.: Ll. Siliqi, *Rruga e lumtunis*, T., 1950.

3) Ll. Siliqi, *Vjersha dhe poema*, T., 1953.

Si prrue, që zbret luginash tue këndue
dhe çdo pengesë rrugës kapërxen,
o vendi im i ri ti shembëllen!

Poezia çelet me vargje, të cilat përshkohen nga një lirizëm gazmor i poetit, që shpreh ndiesitë që i ndjell bregdeti i atdheut. Përshkrimi i një lirizmi të hareshëm pasohet menjëherë nga vargje të fuqishëm për malet e ashpër dhe vigane që «shtielien në ajri...». Nga zemra e poetit shpërthen e vrullshme krenaria për atdheun e ri, i cili krahasohet me një «shqipe krahçelik... syfajkue!», që çan hapësirat.

Flutro, o shqipe, nalt ndër qiej të rij,
flutro e lir', me hovin guximtar, —
flutrim'n e shqipeve na dhe, Parti,
dhe krenarin' që jemi shqipëtarë!

Natyra e blertë me gazin e saj, malet madhështore si kështjella, kaltërsia e detit tonë, plotësojnë kuadrin e atdheut të ri, në të cilin, siç këndon poeti, «nga dielli i partisë / agimi i socializmit sot ka zbardhë!».

Poezia «Atdheut» mbetet një nga lirikat plot emocione të Ll. Siliqit, kushtuar Shqipërisë.

Me zhvillimin e mëtejshëm të jetës së vendit, me rritjen shpirtërore dhe mendore të njerëzve edhe letërsia ecën në rrugën e zhvillimit të saj të mëtejshëm. Poetët nisën ta kuptojnë se koha kërkonte që ndërtimi i jetës së re, në luftë me botën e vjetër dhe vështirësitë e rritjes, të paraqitej përmes ngjarjeve dhe fakteve reale. Me këtë janë të lidhura përpjekjet që ata bëjnë në fillim të viteve '50 për të kaluar nga hymnizimi i jetës së re, në paraqitjen konkrete të saj. Poetët filloi t'i interesojë gjithnjë e më tepër jeta e re e masave të gjera punonjëse. Lindte nevoja e ngushtimit të shprehjes vetëm të ndjenjave të poetit, nëpërmjet futjes në poezi të jetës së njerëzve të thjeshtë. Poezia nis të paraqesë jetën në mënyrë objektive; në të futet subjekti dhe elemente të tjera epike.

Krijimtaria poetike e Ll. Siliqit e kësaj kohe nuk mund të kuptohet jashtë këtyre proceseve, që zhvillohen në poezinë shqipe. Më 1951, i frymëzuar nga një fakt i jetës, ai shkruan poemën «Miku»⁴. Shkasin për këtë vepër poeti e mori nga vizita e udhëheqësit të partisë, sh. Enver Hoxha, në shtëpinë e një fshatari të varfër nga Peza. Në qendër të poemës është vendosur një plak i mocëm fshatar. Hasan Fani. Në këtë figurë poeti pasqyron synimet dhe ndjenjat e hareshme të popullit, i cili, në sajë të partisë, shpëtoi përgjithmonë nga shtypja dhe shfrytëzimi i klasave sunduese, nga varfëria dhe të këqijat, me të cilat ishte plot jeta e tij në të kaluarën. Heroi i poemës ka provuar mbi kurriz egërsinë e sjelljes së bejlerëve, që u pinin gjakun bujqve të varfër. Megjithëse i vetëm, ai nuk e uli asnjëherë kryet përpara të fuqishmëve; prandaj edhe jeta i kaloi në luftë dhe përpjekje të vazhdueshme me armiqtë e klasës së vet. Kjo e ka bërë Hasan Fanin ta çmojë lart lirinë që i solli popullit partia. Gëzimi për jetën e re vihet në dukje me anë të kontrastit me të kaluarën, që del nëpërmjet kujtimeve dhe tregimit të tij.

shum ke ndej' n'kësollat tona,
Hej ti tym, o tym i zi,

4) Rev. «Letërsia jonë», 1951, 5, 9-14; (ribotuar në vëll. *Vjersha dhe poema, cituar*).

por ka ardh' nji vakt i ri
 e nuk duem në tym të zi
 ta gojm' jetën.....

Fjalët «krejt reckos' rrobot e tija, /, porse zemrën plot barot», karakterizojnë me pak viza heroin me shpirtin e tij të paepur dhe dashurinë e zjarrtë për jetën e lirë. Në mënyrë më të plotë ai është shfrytëzuar si-domos te pjesa ku poeti me një ngrohtësi të veçantë përshkruan ndjenjat e reja, që jeta e lirë dhe e begatshme pas çlirimit ka ngjallur në shpirtin e plakut fshatar.

«Eh, shum heret n'bot' ke le,
 shum pak gzim' ke pa mbi dhë,
 shum pak gzim n'kët jet' ke pa!
 Eh, Hasan, o Hasan Fani,
 t'kishe le ma von' paksa!»
 Kshtu me vehte flet Hasani.

Dëshpërimi i tij, se sikur shumë shpejt i erdhi pleqëria dhe s'do të shijojë dot të gjitha gëzimet që solli jeta e re, dëshmon për ndryshimet e mëdha që ka pësuar jeta e popullit, për mendimet dhe dëshirat e reja të masave të popullit. Pikërisht këtu qëndron dhe vlera e figurës së Hasan Fanit. Ndjenjat dhe synimet që ushqen s'janë vetëm të tijat, por të gjithë fshatarësisë punonjëse, së cilës revolucioni i ktheu tokën dhe i krijoi jetën e re.

«Miku» është ndër përpjekjet e para në poezinë tonë për të pasqyruar jetën e re në plan epik realist, përmes përshkrimesh të shtruuara dhe imtësish konkrete. Megjithë karakterin epik në poemë nuk mungojnë notat lirike, që duken si në paraqitjen e botës së brendshme të plakut Hasan ashtu edhe në gërshetimin në të të fjalës së autorit, e cila, nga vetë atmosfera e gëzuar që krijohet në fund të poemës, merr një karakter patetik. Si vepër e tillë ajo qe sukses jo vetëm për poetin, i cili arriti ta japë karakterin e heroit në një ambient real, por edhe për poezinë shqipe në rrugën e saj drejt pjekurisë artistike.

Në poemën «Erë pranverore» (1953)⁵ Ll. Siliqi i vuri si detyrë vetes të pasqyrojë heroin e ri, heroin e kohës. Që në fillim poeti e përcaktoi drejt se ku duhej ta kërkonte heroin e kohës. Personazhet e veprës së vet të re ai i mori nga qendrat e mëdha të ndërtimit socialist. Ata janë dy punëtorë të rritur në atmosferën e re të paçlirimit. Përmes historisë së jetës, të marrëdhënjeve e të dashurisë së Shpresës dhe Agronit, poeti ka synuar të trajtojë disa nga problemet më të rëndësishme që shqetësonin njerëzit tanë në ato vite, si problemin e luftës kundër mbeturinave mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve, qëndrimin ndaj punës, procesin e rritjes shpirtërore e profesionale të puntorëve të rinj në luftë me kapërcimin e vështirësive të ndryshme objektive etj.

Por megjithë përpjekjet poeti nuk ka arritur ta mishërojë këtë ide të rëndësishme përmes figurash dhe pamjesh të gjalla dhe bindëse nga ana artistike. Në poemë nuk ndjehet jeta reale e viteve '50, vështirësitë e vërteta të ndërtimit të shoqërisë së re. «Erë pranverore» doli një vepër për skematike e zbetë. Poema, me subjektin e shpalosur, që ka në qen-

5) Poema ka dy variante: i pari është botuar në vëll. *Vjersha dhe poema* (cituar) dhe i dyti në vëll.: *Kangët nuk mbeten kurr të pakëndueme!* (cituar).

dër dy karaktere njerëzore të përcaktuara, thelbi i të cilave duhet të zbulohet përmes marrëdhënjeve e lidhjeve reciproke, nuk i përshtatej natyrës së talentit të Ll. Siliqit, i cili prirret më tepër nga ndërhyrjet dhe apostrofet e shpeshta liriko-emocionale, se sa nga paraqitja e jetës me mjetet e poezisë tregimtare, epike. Arësye tjetër që poema nuk u godit, është pasqyrimi i përciptë e i zbetë i njerëzve të atyre viteve, i botës së ndjenjave dhe të mendimeve që i karakterizonin. Për ta bërë sa më të besueshme historinë që tregon, autori futi në subjektin e saj vogëlsira, të cilat në vend që të lënë tek lexuesi përshtypjen e diçkaje që ka të ngjarë, dalin të kërkuara, jo të natyrshme, të futura me zor. Mungesa e vërtetësisë, pasqyrimi i përciptë i punës dhe i jetës së heronjve, e kishte burimin edhe tek njohja e pamjaftueshme e jetës, e mendimeve dhe e shqetësimeve të vërteta të rinisë sonë, e procesit të vështirë të kapërcimit të mbeturinave të moralit dhe të ideologjisë së vjetër.

«Erë pranverore», që u botua në vitin 1953, përbën një nga përpjekjet e para të poezisë sonë të re, në fushën e poemës epike tregimtare. Po në atë kohë poetë të tjerë kërkuan të pasqyrojnë ngjarjet dhe herojt në plan epik. Ata i tërheq heroizmi i komunistëve dhe i punonjësve të thjeshtë, të cilët gjatë Luftës nacionalçlirimtare treguan një ndërgjegje të lartë patriotizmi. Kolë Jakova, i frymëzuar nga një fakt historik, shkroi poemën epike «Herojt e Vigut», ku pasqyrohet heroizmi i pesë trimave të rinj, që në një ndeshje të pabarabartë me armiqtë, si kreshnikët me këngë në gojë vdesin për liri. Me nota romantike dhe plot ndërhyrje lirike është paraqitur në poemën «Komunisti» (1953), të L. Qafëzëzit, akti i vërtetë i rënjes heroike të një partizani të ri për të shpëtuar jetën e shokëve të rrethuar nga nazistët. Në poemën epike «Gjeto Plaku» (1954), M. Gurakuqi na njuh me aktin heroik që kryen pas çlirimit një fshatar i thjeshtë, i cili për çështjen e mbrojtjes së vendit nga armiqtë s'kursen as edhe gjënë më të shtrenjtë, jetën. Poema lirike romantike «Zarika» (1954) e A. Çaçit dhe «Rrugë të ndrituna» (1954) e A. Banushit rrokin temën e jetës dhe punës së njerëzve për prodhimin e të mirave materiale.

Ll. Siliqi pas «Erës pranverore» bën një përpjekje tjetër në llojin e poemës tregimtare: më 1955 shkruan poemën «Mësuesi»⁶, duke u frymëzuar nga jeta dhe vepra e guximshme e mësuesit Ndrec Ndue Gjoka, i cili megjithë pengesat e pakapërcyeshme dhe vështirësitë e mëdha e të gjithfarshme të viteve të para pas çlirimit, i nxitur nga dashuria e madhe për malësorët e varfër dhe me këmbëngulje të rrallë, ngriti në Mirditë 50 shkolla filllore.

Poema «Mësuesi» zë një vend të veçantë midis poemave që synojnë të paraqesin më gjerë dhe në veprim heroin të dalë nga gjiri i masave.

Poema tregon për luftën që bëhet në një nga krahinat më të prapambetura si nga pikëpamja ekonomike ashtu edhe kulturele e vendit. Përmes historisë së Ndrec Ndue Gjokës autori shpreh idenë se pa dritë jo vetëm që nuk zhduket shfrytëzimi, por as nuk mund të gëzosh lirinë. Figura e Dritan Shkabës përfaqëson tipin e intelektualit të ri, të kalitur në Luftën nacionalçlirimtare; tek ai janë mishëruar tiparet pozitive të njeriut të ri. Dritani punon në një krahinë të thellë malore ku reaksioni përpiqet të mbjellë në popull mosbesimin ndaj pushtetit të tij; në çdo hap ai ndeshet me armiq tinzarë e të egër dhe nuk tundet nga vepra e tij, sepse e di se 50 mësues të rinj, në 50 fshatra krejtësisht analfabete

6) Ll. Siliqi, *Mësuesi*, T. 1955.

me nga dhjetra e dhjetra nxënës, është një mbështetje e madhe në luftën që bën partia për të mbjellë në atë anë farën e jetës së re. Lufta e tij për të mposhtur errësirën përshkohet nga fryma heroike, gjë që i ka dhënë figurës së Dritanit një karakter të ngritur romantik.

Poeti e pasqyron me ngjyra të gjalla përlëshjen vendimtare të botës së re që përfaqësohet nga Dritani, sekretari i partisë — Bardhoshi dhe fshatarët, me botën e vjetër, me mbeturina të reaksionit, që kryesohen nga kulaku dhe matrapazi Tare Gremçi. Forcat e errëta të së kaluarës, duke e parë se përhapja e arësimit dhe e dritës në popull është vdekje për ta, s'lënë gjë pa bërë për ta penguar dhe kur s'arrijnë gjë, e vrasin pabesisht prapa shpine Dritanit, këtë «komisar të dritës».

Në krahasim me «Erë pranverore» poema «Mësuesi» ka një sërë meritash artistike, si paraqitjen më konkrete të ambientit ku vepron heroi dhe të atmosferës së ndezur në krahinë nga lufta e pushpallur, por e egër që zhvillohet midis dy kampeve armike, vizatimin më bindës të figurës së heroit kryesor, Dritan Shkabës. Megjithatë vepra nuk ka arritur të japë një pamje të plotë dhe të gjallë të realitetit. Duke i vënë si qëllim vetes që të tregojë një histori dramatike, të mbushur me përpjekje dhe ndeshje të forta klasore, poeti nuk ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë që jep për këtë qëllim poema epike.

Dihet, se poema me subjekt ka një sërë kërkesash, si thurjen e një subjekti në mënyrë të natyrshme, paraqitjen dhe zhvillimin e personazheve sipas logjikës së brendshme të tyre, depërtimin e shkrimtarit në botën shpirtërore të herojeve etj. Mirëpo tek «Mësuesi», në përgjithësi nuk ndodh kështu. Ideologjia e protagonistit të poemës, i Dritanit, mosdepërtimi në motivet e veprimeve, pasqyrimi i sipërfaqshëm dhe përmes deklaratimit të ndjenjave dhe mendimeve, e kanë zbehur figurën e tij. Digresionet dhe ndërhyrjet lirike të autorit janë futur në dëm të trajtimit të plotë të figurave, kanë penguar paraqitjen e heroit kryesor me tërë pasurinë e jetës së tij, njëkohësisht me këtë ka pësuar edhe shtjellimi i natyrshëm i subjektit.

Pas poemës «Mësuesi» në krijimtarinë e Ll. Siliqit nis një periudhë, gjatë së cilës poeti u kushtohet krijimeve poetike të llojeve të vogla. Ai shkruan vjersha për sukseset në ndërtimin socialist, për ngjarjet e jetës ndërkombëtare, për gëzimet dhe hallet e njerëzve tanë.

Nga fundi i viteve '50 dhe fillimi i viteve '60 në poezinë tonë merr një përhapje të gjerë poema lirike, që ka formën e një monologu poetik. Në këtë lloj poeme, në të cilën jeta është perceptuar në mënyrë të gjerë, me anë figurash, ngërthejnë përgjithësimet të rëndësishme artistike, spikat një lirizëm i theksuar, bëjnë pjesë poemat «Shënime për brezin tim» (1960) dhe «Ëndërr industriale» (1961) të I. Kadaresë, «Poemë malore» (1962) e D. Agollit, «Republikës» (1962) e F. Arapit, etj. Një vend të merituar në radhën e këtyre poemave zë poema lirike e Ll. Siliqit «Ringjallje», e botuar në 1959⁷.

Poema «Ringjallje» është një kthim i poetit në llojin e poemës lirike, patetike, në llojin e poemës «Prishtina».

Në poemën «Ringjallje» notat liriko-emocionale përbëjnë themelin mbi të cilin mbështetet paraqitja e kuadrit të lulëzuar dhe të gjallë të atdheut.

Duke marrë shkas nga fakte të ndryshme të jetës, poeti shpreh

7) Ll. Siliqi, *Ringjallje*, T., 1960, 52 f.

ngazëllimin e vet për përparimet e mëdha që ka bërë atdheu, nën udhëneqjen e urtë të Partisë.

Figura e mëngjezit pranveror, me të cilën nis poema, e ndihmon poetin të zbulojë idenë e poemës. Kaltërsia e mëngjezit dhe natyra e shumëngjyrshme, që e joshin poetin të këndojë, simbolizojnë përtëritjen e jetës në atdheun tonë të lirë.

U zgjue
 mbarë gjithësija
 Në kopësht dal
 e frymë marr thellë.
 Me fluturue
 të grish thue kaltërsija,
 e qiellit aq të kthjelltë!
 Zbardhon zambaku,
 pemët gjelbërojnë,
 e kaltëra,
 e kuqja,
 boja alle
 kangë me këndue
 të ftojnë,
 me hy
 në të mahnitshmen valle!
 Mirëmëngjez,
 o toka jonë e lirë,
 pa bej,
 tuxhar
 e hasëm!
 Parmendë
 e pushkë
 e pendë,
 vëlla,
 shtërngoji mirë!

Puna kalon nëpër poemë si lajtmotiv, që shpreh frymën poetike të veprës. Poeti e sheh punën si një mjet transformimi jo vetëm të natyrës, por edhe të ndërgjegjes së njerëzve. Të gjithë, të rinj e pleq, ndjehen të përtërirë në atdheun e lirë, ku puna nga një mjet shfrytëzimi në të kaluarën, është bërë një çështje nderi dhe lavdie. Para syve të lexuesit kalojnë shpejt pamje të ndryshme të jetës së vendit, që nga qytetet e reja me oxhakët e lartë të fabrikave dhe të uzinave moderne, fshati i ri, i cili ka hyrë në rrugën e transformimit socialist, e gjer tek bisedat intime të punonjësve në shtëpitë e pushimit, buzë detit.

Ideja e transformimit të botës së njeriut është dhënë bukur sidomos në bisedën e poetit me bashkëudhëtarin e tij. Fshatari plak, i cili më në fund nis të kuptojë të renë, e shpreh me fjalë të thjeshta atë që ndjen, kur sheh perspektivat e ndritura që u hapi masave të popullit partia.

Parti e urtë!
 Na i ban hallall
 padijen e ngurrimet
 kryeneqsinë!

Ideja e poemës spikat më qartë në pjesën e pestë ku poeti i këndon vazhdimisht të jetës, përtëritjes së saj të paprerë. Ka këtu figura plot gaz e dritë. Po karakteri festiv, që nis e tepërohet vende vende në poemë një farë idealizimi të jetës. Poeti u këndon zakoneve dhe virtyteve

të larta të malësorit shqiptar, duke iu shmangur paraqitjes së transformimeve të thella që kanë ngjarë në fshat.

Poema «Ringjallje» është në thelb një poemë lirike. Elementet epike, imtësisht konkrete, pasazhet nga jeta, personazhet e shumta episodike, i shërbejnë zbulimit të idesë së autorit. Një rol të rëndësishëm luan heroi lirik, i cili jo vetëm shpreh ngazëllimin për lulëzimin e jetës socialiste, por merr pjesë aktive në ngjarjet ose bisedat që zhvillojnë personazhet episodike në poemë.

Në punën e përgjithshme për ndërtimin e jetës së re shkrihet edhe puna e vetë poetit, i cili e ndjen veten pjesëmarrës në marshimin e vrullshëm të vendit drejt së ardhmes së lumtur. Ai e ka vënë vargun e vet në shërbim të masave dhe dëshiron që poema e tij të jetë «parullë e zjarrrë kushtrimi» dhe «hymën» i ringjalljes së atdheut. I bindur se poetët këngëgjithnjë e më të bukura do t'i thurin atdheut, ai e ndjen veten krenar se është nga të parët që vë gurë në themele të komunizmit.

Për ty,
 Shqipni
 të tjerë poetë do thurin
 ma t'bukrat kangë!...
 E na
 do jem' krenarë,
 që nga duert tona
 ju e rroktë flamurin,
 nga t'parët tanë
 që e rrokëm na ma parë!
 Do jem' krenarë,
 që fjalën «Komunizëm»
 e shkruem të parët
 na
 në atë flamur!

«Ringjallje» është poema ku spikat më qartë karakteri lirik emocional i vargut të Ll. Siliqit. Përshëndetja e poetit për tokën e ringjallur, apostrofat drejtuar brezit të ri, thirrjet retorike kthehen në një brohor të zjarrrë dhe plot kumbim, drejtuar atdheut.

Tashti,
 tashti e dij ma mirë
 se si qëndroi
 ky popull
 kaq i lirë,
 si s'u përkul
 në orën e vështirë!
 Si s'e rrëzoi
 as topi,
 as robnija
 e as shtriga kockëdala —
 vorfënija!

Poema «Ringjallje» shënon kulmin e krijimtarisë poetike të Ll. Siliqit. Vitet '60 karakterizohen nga ngjarje të rëndësishme në jetën e vendit. Në këtë kohë në Shqipëri kishin triumfuar plotësisht marrëdhënjet socialiste, u zhduk prona private dhe bashkë me të edhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut. Ndërtimi i bazave të shoqërisë socialiste hapi perspektiva të ndritura për zhvillimin e vrullshëm të vendit. Sukseset e arritura në të gjitha fushat ngjallën një entuziazëm të madh në masat punonjëse, të cilat iu përveshën punës për të përmbushur detyrat e reja që dilnin. Po në këtë kohë ata ndeshën vështirësi të reja, që nisi të nxirrte udhëheqja

revizioniste sovjetike, me qëllim që të pengonte ngritjen e shoqërisë socialiste në Shqipëri. Veprimeve të këtyre armiqve të rinj, populli shqiptar iu përgjigj duke e rritur vendosmërinë për të çuar përpara ndërtimin socialist. Në të gjitha anët e vendit shpërthyen inisiativa të shumta, në të cilat u shpreh patriotizmi i lartë dhe vetëdija e thellë politike e masave punonjëse.

Në këto rrethana fitoi një aktualitet të veçantë tema e patriotizmit socialist, tema e forcës dhe e gjallërisë së popullit shqiptar, i cili me gjithë rebeshet që i ranë mbi krye gjatë shekujve, jo vetëm s'u shojt, por ruajti gjuhën, kulturën dhe vijoi marshimin e vet ngadhënjimtar në rrugën e historisë. Shumë poetë hartuan vjersha, në të cilat ngrinin lart frymën e paepur të popullit shqiptar, dashurinë e tyre të madhe për vendin, urrejtjen e pashuar kundër skllavërisë dhe shpirtin e tyre liridashës. Në poezitë «Kanga e natës», «Kangë entuziaste», «Brez mbas brezi»⁸, Ll. Siliqi kujton kohët e moçme, kur, siç ligjërojnë malet e larta, Shqipëria s'e rrdeli asnjëherë vrullin e vet, duke çarë gjithnjë përpara. Ndërtuesit e shoqërisë së re, thotë poeti në «Brez mbas brezi», kanë trashëguar virtutet më të çmueshme të paraardhësve të tyre. Sot vigaj janë komunistët, të cilët u prijnë kreshnikëve. Fisniket e dikurshme tani çjerrin kanunet, zbukurojnë gjoksin me dekorata dhe zgjedhin vetë trimin që u pëlqen. Ideja, se masat punonjëse po ndërtojnë shoqërinë socialiste në garë me kohën, sukseset që ja kanë ndërruar fytyrën atdheut, ngjallin krenari të ligjshme te poeti.

Për hapat e bëra përpara, për kombinatet madhështore, për tharjen e kënetave, për puntorët dhe novatorët, poeti ngjatjeton tokën e lirë. Jeta e re në atdheun e ri është më poetike se poezia. («Kangë entuziaste»). Si pasojë e transformimeve të botës materiale, thotë poeti, ka ndryshuar edhe ndërgjegjja e njerëzve. Naftëtarët, duke përtërirë frymën e luftës partizane, përlëshen me zjarrin, sepse janë të ndërgjegjshëm për rolin pararojë të klasës së tyre.

Figurën e atdheut të ri socialist, autori e krijon me anë imtësisht shumë shprehëse për pamjen e sotme. «Oxhaqet e fabrikave të reja / në sfond të maleve të moçme», njerëzit që janë vënë në garë me kohën, shkollat e reja dhe të thjeshta në malësi, vashat që endin pëlhurë, flota e re që çan detin me krenari, filmat apo baletet e rinj, me «të pastrin / të pamposhtunin flamur», partinë, në krye, përbëjnë kuadrin madhështor të atdheut të ri, i cili del në pah në përqasje me portretin e vet në të kaluarën.

«Kangë entuziaste» e poetit mbyllet me vargje plot epitete të goditura, që sintetizojnë jetën dhe veprën e partisë, burimit të frymëzimi dhe të fitoreve të popullit tonë në ndërtimin e jetës së re në tokën shqiptare.

Partija —

plaku i urtë në jetë vaditë,
djaloshi zemërzjarrtë e syskifter.

Partija —

shkamb, që then stuhitë.

Partija —

ma i pari brigadier,
flamuri ngadhënjimtar në çdo luftim,
nanë që s'mbyll sy në gaz e hldhërim.

Partija —

duerçelikti timonier.

Themelet mburjtë — me gjakun e dëshmorëve.

Godina ngritë — me djersën e puntorëve.

8) Ll. Siliqi, *Kangë entuziaste*, T., 1962.

Në «Kanga e natës» poeti vizaton një natë tipike të Shqipërisë së re. Në polemikë të heshtur me ata poetë, të cilët i tërheq nata me qetësinë e saj, autori thekson gjallërinë e natës, të mbushur me zhurmën e punës. Natën atdheu jo vetëm s'pushon, por vigjëlon me syrin pishë. Vetë figura e natës e mbushur me jehonën e punës ndërtime të del si një simbol i dinamizmit dhe ecjes së pandalshme të atdheut socialist.

Motivi i punës së lirë krijuese, si pjesë përbërëse e temës së ndërtimit, zë një vend të rëndësishëm në këtë poezi. E ngjeshur me imtësira shprehëse është pjesa, ku nata përshkruhet si natë e bukur pune ndërtime.

Në turn të natës. Punëtorët
s'i tremben asnjë barre!
Atdheut të ri
ndër ara i duhen plorët?...
Çfryn xixa gryka e furrës n'fonderi
kah derdhet giza si ujvare, —
për kremte
me t'bukrat fishekzjarre!
.....
Armët në krah,
fshatarët kqyrin fushën.
Errsinën çpon me sytë vezlues traktori.
Me pushkë e pluer,
me kangët ma t'zjarrta në krahnuer,
drejt majës ma të lartë flutrojmë kaluer!
.....

Tema e jetës së re gjen një pasqyrim edhe në poemën «Pranvera e madhe»⁹⁾. Titulli zbulon qartë idenë e veprës. «Pranvera e madhe», e cila ka filluar të lëshojë gonxhe, e ka bazën në përpjekjet për ndërtimin e jetës së re dhe në luftën e papajtueshme me armiqt dhe të vjetrën. Poema synon të shtjellojë idenë se e tashmja i ka rrënjët në të kaluarën; ajo lind të ardhmen. Ndryshimet që ka pësuar vendi ynë janë të tilla që mahnisin dhe frymëzojnë çdo njeri. Simbol i shndërrimeve madhështore që kanë ngjarë në jetën e Shqipërisë është qyteti i ri i Laçit. Për poetin veprat madhështore dhe lufta e vendosur që bën klasa punëtore kundër çdo shfaqje të huaj në ndërtimin dhe jetën e qyteteve të reja, përbëjnë autobiografinë e ndërtuesve të tyre.

Në poemë tek disa episode, në të cilat tregohet si triumfon e reja në luftë kundër së vjetrës. Shprehëse është pjesa, në të cilën rrëfëhet për ndikimin që ushtron ambienti i ri në ndërgjegje të malsorit, me koncepte të vjetra.

Mirëpo karakteri fragmentar, lidhja artificiale e së ardhmes me të sotmen, episodet e shumta që qëndrojnë larg brendisë së poemës, kanë penguar shtjellimin e idesë së poetit, i cili disa herë përsërit mendime të shprehura në krijimet e mëparshme poetike të tij.

Kalimi i vendit në rrugën e revolucionarizimit të mëtejshëm e pasuroi me brendi të re krijimtarinë poetike të Ll. Siliqit. Poeti shkroi një varg krijimesh, në të cilat u bën jehonë ngjarjeve të rëndësishme të jetës së vendit në këto vjetët e fundit. Merita e këtyre poezive qëndron kryesisht në faktin se ato u kanë bërë jehonë flakë për flakë problemeve të mëdha politike, ekonomike e shoqërore që dolën para shoqërisë sonë socialiste pas Letrës së hapur. Gjithnjë poetin e tërheq heroizmi i puno-

9) Ll. Siliqi, *Pranvera e madhe*, T., 1966.

njësve, aspektet solemne dhe festive të jetës së re gjer thellë në malësi.

Një nga poezitë e frymëzuara gjatë viteve të fundit është «Nder sytë e shoqeve — shkëndija»¹⁰. Ll. Siliqi e drejton vëmendjen në luftën e madhe që ka shpërthyer për emancipimin e graas. Atë e entuziazmon forca e madhe që përbëjnë «qinda e mija» të reja, të cilat kanë ndezur zjarrin e madh,

që përcëllon dinakë e burracakë,
djeg nenet shtazarakë,
shkrumbon një botë
plakë e stërplakë.

Si kushtrim tingëllojnë vargjet e poezisë «Jetojmë, na shokë, në koh'n e poezisë»¹¹, në të cilën është shprehur romantika revolucionare e periudhës historike nëpër të cilën po kalon vendi kohët e fundit. Ajo është thurur si një këngë luftarake, me ritëm dinamik, që i transmeton leuesit dinamizmin e ditëve të sotme.

Një nga temat që është e lidhur ngushtë me atë të ndërtimit socialist, në krijimtarinë poetike të Ll. Siliqit, është ajo e partisë. «Kur flet Partia»¹² u shkrua me rastin e Kongresit V të PPSH. Partia, që trashëgon gjithshka përparimtare dhe revolucionare nga historia e popullit në të kaluarën, që «...pi në gurrat e përjetshme / të maleve shqipitare», që e gjallëron gjithnjë «flaka proletare», është «flamur / që drejt ngadhënjimesh prin gjithmonë». Partia, burim i pashtershëm i jetës së re, i frymëzon dhe i mëson punonjësit, si të ndërtojnë jetën e re socialiste, si të sulmojnë në betejat ndërtimtare, si të kërkojnë dhe të zbulojnë vazhdimisht energji të reja, i mëson «flamurin sa ma naltë me e ngulë».

Edhe poema «Borizanët»¹³, e cila është nga poemat e para që u shkrua menjëherë pas Letrës së hapur, ka pjesë që pasqyrojnë frymën luftarake të kohës. Sipas konceptit poetik, me borizanët, autori ka dashur të paraqesë heronjtë e kohëve të reja, punëtorët revolucionarë, të rinjtë dhe të rejat, të cilët lëshojnë kushtrimin për të sulmuar në të gjitha frontet e ndërtimit të socializmit. Mirëpo kjo është realizuar vetëm pjesërisht; në poemë vendin kryesor e kanë zënë gjëra që pak lidhen me idenë kryesore të veprës.

Megjithatë poema ka pjesë që janë të frymëzuara. Të tilla janë ato ku poeti u bën thirrje edhe të prapambeturve që të ecin me kohën, me jetën, në luftën për transformimin e natyrës:

tok shkambin ta thërmojmë,
tok shpatin ta gërmojmë,
ta kthejmë
taracë

.....
Të tranden malet me poterë,
ta ndjejnë ma fort përherë:
ndër male po këndojnë

10) Ll. Siliqi, *Nga porti i ri deri ku vlon malsia*, T., 1967.

11) Vëll. i cituar në shën. 10.

12) idem.

13) idem.

Perceptimi jo i qartë i saj se çfarë do të shprehesh në figurën e bozizanit, fiksimi i mbresave dhe i përshkrimeve që nuk ndihmojnë për dhënjën e idesë qendrore, idealizimi dhe shikimi naiv i jetës së malësisë, retorizmi i tepruar, e kanë zbehur idenë e poemës.

Më sipër u përpoqëm të paraqesim trajtimin e temës së re në krijimtarinë poetike të Ll. Siliqit, lidhur ngushtë me rrugën e zhvillimit të poetit dhe tiparet kryesore të stilit të tij.

Pathosi i muzës së tij është pathosi qytetar. Kënga e tij ngrihet si një hymn kushtuar ndërtimit të shoqërisë socialiste. Poezia e tij u ka bërë jehonë të menjëhershme ngjarjeve më të rëndësishme politike, shoqërore dhe ekonomike të jetës së vendit, siç janë ndërtimi i socializmit, heroizmi i punonjësve, lufta kundër mbeturinave në ndërgjegjen e njerëzve, demaskimi i armiqtve të atdheut e të socializmit etj.

Duke mos pasqyruar në mënyrë të gjerë dhe të thelluar jetën dhe veprën e njerëzve të rinj nëpërmjet gjinisë epike narrative, Ll. Siliqi kthehet në lirikën emocionale plot kumbim dhe shkruan një serë veprash, ndër të cilat poema lirike «Ringjallje», shënon kulmin e krijimtarisë së tij poetike.

Krijimi poetik i Ll. Siliqit, me patosin e lartë afirmues të realitetit, me vargun plot ndjenja të vrullshme dhe të fuqishme, është një dëshmi e frymës së lartë të partisë proletare, e qartësisë së mendimit dhe e ndjenjave të optimizmit të poezisë sonë të realizmit socialist.

R é s u m é

LA THEMATIQUE DE LA VIE NOUVELLE DANS LA CREATION POETIQUE DE LL. SILIQI

Llazar Siliqi est du nombre de ces hommes de lettres qui non seulement ont salué le triomphe de la révolution populaire, mais qui ont pris aussi une part active à la lutte populaire à ouvrir le chemin à la victoire sur les envahisseurs étrangers et les traîtres.

Après la libération du pays, et, notamment, durant les années d'édification socialiste, le poète déploie une vaste activité socialo-littéraire. La thématique des créations poétiques de Siliqi est déterminée par les tâches les plus urgentes et les plus grandes politiques et sociales du temps.

La figuration de la vie nouvelle se manifeste déjà avant la libération du pays, mais du seul ressort d'un rêve romantique du jeune poète. Après le triomphe de la révolution populaire, le reflet des efforts des masses laborieuses pour l'édification de la vie nouvelle commence à prendre de plus en plus de place dans l'oeuvre poétique de Ll. Siliqi. Tout sujet qu'il traite, soit-il tiré de la lutte de libération nationale que notre peuple venait à peine de terminer, soit quand il fait ôter le masque aux manoeuvres et aux intrigues des forces impérialistes, notre poète vise à le rapprocher à la naissance et à l'affirmation du nouveau monde (le poème Prishtine). Ll. Siliqi a produit également une série de poésies lyriques aux notes poétiques émotionnelles.

L'auteur de cet exposé L. Kokona suit également, pas après pas, l'évolution de la thématique de la nouvelle vie, sortie de la plume de Ll. Siliqi à l'aide de l'analyse de tous les poèmes et les poésies les plus

réussies, examinés dans le cadre des problèmes politiques et sociaux et celui de la littérature contemporaine. Il fait découvrir ainsi plusieurs des traits principaux de sa poésie.

Au commencement des années 50, à mesure de l'essor de plus en plus grand que prenait le pays, les poètes font effort à brosser par des couleurs plus effectives et animées la vie nouvelle, en passant des lyriques hymniques, souvent déclaratives, à la culture du genre du poème épique. Ll. Siliqi s'essaie d'écrire des poèmes à sujet, empreints souvent de lyrisme et d'interventions lyriques de l'auteur.

Le poème Miku (L'hôte — 1951) est une des premières tentatives de notre poésie contemporaine à refléter la vie nouvelle sur un plan épique réaliste, au moyen des descriptions soutenues et des détails concrets.

Dans son poème Erë pranverore (Vent de printemps — 1953) il s'est mis pour tâche de brosser le nouveau héros, le héros de son temps. Pourtant, malgré son effort, Siliqi n'est pas parvenu à faire mouler l'idée importante de l'oeuvre, dans des figures et des vue artistiques animées et convaincantes.

Par rapport à Erë pranverore, le poème Mësuesi (Le maître — 1955) a une série de mérites artistiques frappants, comme l'ébauche plus concrète du milieu où agit le héros, etc. Néanmoins, aussi ce poème à sujet n'est pas parvenu à brosser une vue complète et animée de la vie de son temps.

Etant donnée que le poème à sujet n'allait pas à la nature de son talent, vers la fin des années 50 Siliqi retourne au poème lyrique, et, en concordance avec les particularités de son talent, il écrit le poème Ringjallje (Renaissance — 1959). Ce poème qui chante dans l'esprit lyrique et émotionnel et sur des tons élevés au développement de notre pays et de notre peuple sur le chemin de l'édification de la vie nouvelle, abonde en détails concrets, vivants, réalistes. Le sujet de la vie nouvelle trouve son incarnation idéo-artistique en concordance avec le style du poète. Ce poème marque le faite de la création poétique de Ll. Siliqi.

Dans les années 60, à la suite d'une suite de nouvelles circonstances sur échiquier national et international à la fois, le sujet de l'édification du socialisme s'enchevêtre à celui du patriotisme socialiste, en se rattachant encore plus intimement au passé glorieux du pays et aux traditions progressistes de nos ancêtres.

Le principal trait qui caractérise les meilleures créations poétiques de Ll. Siliqi, il est dit entre autres en conclusion, est la lyrique émotionnelle, qui fait un écho immédiat, sur des notes élevées, aux événements les plus marquants de la vie politique, économique et sociale. Sa lyrique est une expression de la joie du poète pour l'édification de la société nouvelle. Elle se fait remarquer par le haut esprit du parti prolétarien, par la clarté d'opinion et le sentiment d'optimisme.

